



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/1118**  
**Data e Vendimit: 25.11.2024**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, , i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenin 17 paragrafi 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik "Ideal Partners" Sh.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime me numër të prokurimit 206-24-187-5-1-1, iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e autoritetit kontraktues, zv. Kryesuesi Sekretariatit i Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Agim Sheqiri me datën: 25.11.2024, mori këtë:

## Vendim

Hedhet si e palejuar (parakohshme) ankesa e OE. "Ideal Partners" Sh.P.K. me nr. të protokollit 2024/1118, e datës 18.11.2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime" me numër të prokurimit 206-24-187-5-1-1, iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë, nga cilësia e tij/saj si autoriteti kontraktues (AK).

I lejohet, Autoritetit Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime me numër të prokurimit 206-24-187-5-1-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

## Arsyetim

*-Faktet dhe rrethanat procedurale-*

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 18.11.2024 ka pranuar ankesën me nr.1118/2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime me numër të prokurimit 206-24-187-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shtime" me numër të prokurimit 206-24-187-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë ndërsa me datë 17.10.2024 ka publikuar B05 Njoftimin për kontratë të AK. Për të cilën OE ankues "Ideal Partners" Sh.P.K. në platformën E-Prokurimi nuk figuron që OE ankues ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së, para se i njëjti ti drejtohet OSHP-së me Ankesë.

OSHP sqaron se OE Ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me nenin 108/A të LPP-së pas pranimit të vendimit nga ana e Autoritetit Kontraktues, brenda afateve ligjore të parashtrorjës kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund të drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 1 i LPP-së përcakton se: "Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërliken me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit." Ndërsa neni 109 i LPP-së përcakton se: "Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrorjë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji lidhur me nenin 59 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, andaj si e tillë hedhet si e pa lejuar në kuptimin si e parakohshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

AK Ministria e Shëndetësisë, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shtime" me numër të prokurimit 206-24-187-5-1-1, megjithatë OSHP i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK ,duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 dhe 65 të LPP-së.

Po ashtu, zyra për financa, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë e pagesës siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Zv Kryesuesi i Sekretariatit në OSHP, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - IDEAL PARTNERS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: